

SEAMENT ALBANIA sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 – 26

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe artakëve të Shoqërisë Seament Albania sh.p.k.

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë Seament Albania sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2015, pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Bazat për Opinion me Rezervë

Siç përshkruhet në shënimin numer 9 të pasqyrave financiare, gjendja e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 është 421,9 milion Lekë, prej te cilave një pjesë e konsiderueshme është e krijuar prej më shumë se një vit. Shoqëria nuk ka krijuar ndonjë zhvlerësim për këto llogari të arkëtueshme.

Mbi baze të informacioneve që kemi marrë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë korrigjim i mundshëm nga zhvlerësimi i mëtejshëm i llogarive të arkëtueshme do të kishte në pasqyrat financiare të shoqërisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së tyre të rikuperueshme do ulte vlerën e aktiveve dhe te kapitaleve të veta në të njëjtën masë.

Opinionimi me Rezervë

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **Seament Albania sh.p.k.** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar.



Rr. Emin Duraku Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 60 15
www.mazars.al, info@mazars.al

30 Mars 2016

Diana Ylli (Golemi)
Partner Angazhimi

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	5	123,012,605	116,363,691
Investime të tjera afatgjata	6	77,970,914	77,970,914
Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	7	765,015,900	765,015,900
Total aktiveve afatgjata		965,999,419	959,350,505
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	8	75,000	760,138
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	421,933,433	414,315,136
Llogari të arkëtueshme nga palë të lidhura	29	203,798,831	309,717,776
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	44,515,025	47,013,344
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	11	4,494,102	3,973,890
Mjetet monetare	12	496,262	605,762
Total aktive afatshkurtra		675,312,653	776,386,046
Total aktive		1,641,312,072	1,735,736,551
KAPITALI			
Kapitali nënshkruar		409,087,862	409,087,862
Rezerva të tjera			
Fitime/ (humbje) të mbartura		(363,331,166)	(187,530,796)
Fitimi i ushtrimit		(138,274,965)	(175,800,370)
Totali kapitali	13	(92,518,269)	45,756,696
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Pjesa afatgjatë e huasë	14	67,394,334	253,534,222
Detyrime të tjera afatgjata	15, 29	810,367,224	742,337,349
Total detyrime afatgjata		877,761,558	995,871,571
Detyrime afatshkurtra			
Pjesa afatshkurtër e huase afatgjatë	16	190,531,106	48,780,705
Hua afatshkurtra	17	306,820,244	325,980,448
Llogari të pagueshme tregtare	18	212,369,647	285,853,699
Llogari të pagueshme palë të lidhura	30	142,282,176	27,553,861
Parapagime të arkëtuara	19	874,607	801,184
Detyrime tatimore	20	528,031	913,211
Llogari të pagueshme të tjera	21	2,662,972	4,225,176
Total detyrime afatshkurtra		856,068,783	694,108,284
Totali i detyrimeve		1,733,830,341	1,689,979,855
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,641,312,072	1,735,736,551

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të Ardhurave të tjera Gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura	22	661,199,836	660,077,550
Të ardhura të tjera	23	7,364,095	7,199,594
Materiale të para dhe të konsumueshme	24	(614,110,142)	(595,712,962)
Shpenzime personeli	25	(23,142,465)	(25,676,551)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	5, 26	(6,428,328)	(7,531,059)
Shpenzime të tjera	27	(39,323,979)	(37,945,372)
Fitimi operativ		(14,440,983)	411,200
Shpenzime interesi dhe te ngjashme (neto)	28	(44,691,830)	(35,844,352)
Shpenzime te tjera financiare (neto)	29	(79,142,152)	(140,367,218)
Total shpenzime financiare		(123,833,982)	(176,211,570)
Fitimi para tatimit		(138,274,965)	(175,800,370)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzime tatim fitimi i shtyrë		-	-
Fitimi i vitit	30	(138,274,965)	(175,800,370)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse per vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(138,274,965)	(175,800,370)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 26, të citat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**SEAMENT ALBANIA
SH.P.K**

SEAMENT Albania sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali nëshkruar	Rezerva të tjera	Fitim/(Humbje) të mbartura	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
Gjendja më 1 janar 2014	409,087,862		(144,893,526)	(42,637,270)	221,557,066
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin				(175,800,370)	(175,800,370)
Transferim në fitime të mbartura			(42,637,270)	42,637,270	-
Dividendë të paguar					-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	409,087,862		(187,530,796)	(175,800,370)	45,756,696
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin				(138,274,965)	(138,274,965)
Transferim në fitime të mbartura			(175,800,370)	175,800,370	-
Dividendë të paguar					-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	409,087,862		(363,331,166)	(138,274,965)	(92,518,269)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori më ___ Mars 2016 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:




Z. Enea Hoxha
Hartues i Pasqyrave financiare



Z. Edward Samaha
Administrator



CHARLES BOURI
Z. Charles Michael Bouri
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(138,274,965)	(175,800,370)
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,428,328	7,531,059
Shpenzime financiare	5,433,761	2,865,504
Interesa të përlllogaritura	16,771,557	10,089,493
Shpenzime për interesa	27,920,273	35,844,352
Diferenca konvertimi të perealizuara	72,824,793	127,687,049
Diferenca konvertimi të realizuara	-	(274,828)
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	(8,896,253)	7,942,259
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	685,138	(672,332)
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	5,672,264	580,063,606
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme me palë të lidhura	113,796,910	-
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	(90,191,118)	(597,823,594)
Ndryshimi në llogari të pagueshme palë të lidhura	113,271,162	-
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	(520,212)	(415,555)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	133,817,891	(10,905,616)
Interesa të paguara	(27,920,273)	(35,844,352)
	(27,920,273)	(35,844,352)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(13,077,242)	(12,000)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(13,077,242)	(12,000)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	(190,576,242)	112,437,755
(Ripagim)/ të hyra nga huatë afatshkurtër	103,080,128	(63,211,229)
Shpenzime Financiare	(5,433,761)	(2,865,504)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(92,929,876)	46,361,022
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(109,500)	(400,946)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	605,762	1,006,708
Mjetet monetare në fund të periudhës	496,262	605,762

12

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SEAMENT ALBANIA
SH.P.K

1. Informacion i përgjithshëm

SEAMENT ALBANIA sh.p.k ("Shoqëria") është krijuar më 23.04.1994 sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ortak të vetëm SEAMENT HOLDING .Tashme veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi i materialeve të ndërtimit,tregtim i cimentos dhe i materialeve të tjera të ndërtimit.

Kapitali i Shoqërisë është 409,087,862 Lekë i zotëruar 100% nga Seament Holding .

Kompania është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim-Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT J61827093K. Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugën "Abdyl Frashëri", Tiranë.

Administratori i Shoqërisë është Z.Charles Michael Bouri .

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 24 punonjës (2014: 26 punonjës)

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen për herë të parë për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015.

- *SNRF 2 – qartëson përcaktimin e "Konditës së kushtëzimit" dhe bën dallimin ndërmjet 'kushtit të performancës' dhe 'kushtit të shërbimit'.*
- *SNRF 3 – qartëson se një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar klasifikohet si detyrim financiar ose si kapital bazuar në parimet e SNK 32 (Instrumentet Financiare: Paraqitja) dhe se e gjithë shumta e kushtëzuar (detyrim financiar ose jo) matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi.*
- *SNRF 3 – qartëson se SNRF 3 nuk gjen zbatim në kontabilizimin e lidhjeve të marrëveshjeve të përbashkëta.*
- *SNRF 8 – kërkon shënime shpjeguese sa i përket gjykimeve të Menaxhimit në lidhje me konsolidimin e segmenteve të aktivitetit të kompanisë dhe qartëson se për një rakordim të segmenteve të aktiveve mund të jepen shpjegime vetëm nëse segmentet e aktiveve bëhen të njohura.*
- *SNRF 13 konfirmon se llogaritë e arkëtueshme apo të pagueshme afatshkurtra mund të vazhdojnë të maten me vlerën e faturuar nëse impakti nga skontimi është jomaterial.*
- *SNRF 13 - sqaron se përjashtimet në SNRF 13 (matja e vlerës së drejtë të një grupi aktivesh dhe detyrimeve financiare mbi bazë neto) zbatohet për të gjitha kontratat brenda objektit të SNK 39 ose SNRF 9*
- *SNK 16 dhe SNK 38 – sqarojnë se si trajtohen vlera e mbetur dhe amortizimi i akumuluar në rastin kur një entitet kryen rivlerësim të aktiveve.*
- *IAS 24 – sqaron se kur një entitet merr shërbime menaxhimi nga personeli i një pale te Iretë (një entitet menaxhimi), tarifat e paguara për ato shërbime duhet të pasqyrohen në shënimet shpjeguese nga entiteti raportues, por jo pagesa që entiteti i menaxhimit i bën punonjësve apo drejtorëve të tij.*
- *IAS 40 – sqaron se SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë reciprokisht ekskluzive në bërjen e dallimit midis pronës së investimit dhe pronës që shfrytëzohet nga pronari dhe përcaktimin nëse blerja e një prone investimi mund të cilësohet si një kombinim biznesi.*

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (Vazhdim)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Amendimi ndaj SNK 19 – “Përfitimet e punonjësve” (publikuar në nëntor 2013 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014). Ndryshimet sqarojnë kontabilizimin për përfitimeve e punonjësve të cilat kërkojnë që punonjësit apo ndonjë palë e tretë të kontribuojnë drejt kostos së përfitimeve. Këto ndryshime lejojnë kontributet që lidhen me shërbimet, por që nuk ndryshojnë me jetëgjatësinë e shërbimit të punonjësit, (p.sh. si një % fikse ndaj pagës), të zbriten nga kosto e përfitimeve gjatë periudhës që shërbimi është ofruar. Për këtë, shumë entitete mund të vazhdojnë (por nuk janë të detyruara) të kontabilizojnë kontributet e punonjësve duke përdorur politikat e tyre aktuale të kontabilizimit.

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emtuar por nuk janë ende efektive:

Deri më datë 30 prill 2015, standardet dhe interpretimet si më poshtë të publikuara nuk kanë qenë të detyrueshme për periudha raportuese që mbarojnë më 31 dhjetor 2015:

- Amendimi ndaj SNRF 9 – “Instrumentat Financiare” (publikuar në korrik 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht për periudha financiare që fillojnë më 1 shkurt 2015).
- Amendimi ndaj SNRF 10 dhe SNK 28 – “Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe partnerit në një sipërmarrje të përbashkët” (publikuar në shtator 2014, dhe me datë efektive të shtyrë derin në një deklaram të dytë).
- Amendimet ndaj SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 – “Investimet në pjesëmarrje: Aplikimi i përjashtimeve të konsolidimit” (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Amendimi ndaj SNRF 11 – “Kontabilizimi i blerjeve të Pjesëmarrjeve në Marrëveshje të Përbashkëta” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016).
- SNRF 14 – “Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore” (publikuar në janar 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016).
- SNRF 15 – “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht)
- Amendimi ndaj SNK 1 – “Iniciativë mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese” (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).
- Amendimi ndaj SNK 16 dhe SNK 38 – “Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Amortizimit dhe Zhvlerësimit” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas datës 1 janar 2016).
- Amendimet ndaj SNK 16 dhe SNK 41 – “Bujqësia: Bimët Bartëse” (publikuar në qershor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas dates 1 janar 2016).
- Amendimi ndaj SNK 27 – “Metoda e Kapitalit në pasqyrat financiare individuale” (publikuar në gusht 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfilimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime të përgjithshme	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të gjitha vlerat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqel që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.14. Krahasueshmëria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhen aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur me mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

SEAMENT Albania sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015

Të gjitha vlerat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe

5. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Aktive në proces	Totali
<i>Kosto</i>								
Gjendja më 1 janar 2014	45,469,674	117,914,708	205,609,039	85,255,152	14,731,878	18,666,650	-	487,647,101
Shtesa					12,000		-	12,000
Pakesime								-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	45,469,674	117,914,708	205,609,039	85,255,152	14,743,878	18,666,650	-	487,659,101
Shtesa					10,575		13,066,667	13,077,242
Pakesime								-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	45,469,674	117,914,708	205,609,039	85,255,152	14,754,453	18,666,650	13,066,667	500,736,343
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
Gjendja më 1 janar 2014	-	62,621,020	191,886,680	78,392,286	13,614,590	17,249,775	-	363,764,351
Pakesime	-	2,764,684	2,744,472	1,379,740	242,914	399,249	-	7,531,059
Gjendja më 31 dhjetor 2014	-	65,385,704	194,631,152	79,772,026	13,857,504	17,649,024	-	371,295,410
Amortizimi i vitit	-	2,626,450	2,195,579	1,096,625	202,188	307,486	-	6,428,328
Pakesime	-							-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	68,012,154	196,826,731	80,868,651	14,059,692	17,956,510	-	377,723,738
<i>Vlera neto kontabël</i>								
Gjendja më 31 dhjetor 2014	45,469,674	52,529,004	10,977,887	5,483,126	886,374	1,017,626	-	116,363,691
Gjendja më 31 dhjetor 2015	45,469,674	49,902,554	8,782,308	4,386,501	694,761	710,140	13,066,667	123,012,605

SEAMENT ALBANIA
SH.P.K

EDMIR DIMITRI

CHARLES BONI

15

Të gjitha vlerat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe

6. Investime të tjera afatgjata

Në këtë zë janë përfshirë apartamentet për rishitje , balanca e të cilave më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Investime të tjera afatgjata	77,970,914	77,970,914
	<u>77,970,914</u>	<u>77,970,914</u>

7. Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara

Pjesëmarrjet në njësitë e kontrolluara detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Elbasan Cement Factory	648,510,000	648,510,000
United Quarries	115,600,000	115,600,000
Uniland	100,000	100,000
ISM	100,000	100,000
Lebalco	100,000	100,000
Seament Makedonia	605,900	605,900
	<u>765,015,900</u>	<u>765,015,900</u>

Ortaku i shoqërisë Seament Holding ka vendosur si kolateral 77% të kuotave që Seament Albania zotëron tek Elbasan Cement Factory dhe 86% të kuotave që zotëron tek United Quarries.

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Materiale ndihmëse	75,000	747,332
Lëndë djegëse	-	12,806
	<u>75,000</u>	<u>760,138</u>

9. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë	421,933,433	414,315,136
	<u>421,933,433</u>	<u>414,315,136</u>

10. Llogari të arkëtueshme të tjera

Balanca e llogarive të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Paradhënie për personelin	3,623,050	4,853,051
Tatim Fitimi Parapaguar	24,054,929	24,054,929
TVSH për t'u marrë	199,433	1,127,781
Të tjera	16,637,613	16,977,583
	<u>44,515,025</u>	<u>47,013,344</u>

11. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Parapagime për furnitorët	2,733,042	2,212,830
Garanci për ambiente me qera	1,761,060	1,761,060
	<u>4,494,102</u>	<u>3,973,890</u>

12. Mjete monetare

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	496,262	605,762
Llogari rrjedhëse	496,262	605,762
Depozita me afat	-	-
Mjete monetare në arkë	-	-
	<u>496,262</u>	<u>605,762</u>

13. Kapitali

Kapitali i kompanisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është 409,087,862 Lekë i zotëruar 100% nga Seament Holding .

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Numri kuotave	409,087	409,087
Vlera nominale	1,000,000	1,000,000
	<u>409,087,862</u>	<u>409,087,862</u>

Rezervat e tjera më 31 dhjetor 2015 janë në vlerën 515,255,912 Lekë .

Humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2015 janë në vlerën (878,587,078) Lekë.

14. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Hua Afatgjatë Prespa Invest	27,456,000	168,168,000
Hua Afatgjatë Intesa San Paolo Bank	39,938,334	85,366,222
	<u>67,394,334</u>	<u>253,534,222</u>

15. Detyrime të tjera afatgjata

Detyrimet e tjera afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përfaqësojnë vlerën e marrë hua nga kompania mëmë :

Vlera e detyrimit në monedhen origjinale është 6,442,223 USD (2014: 6,442,223 USD).

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Seament Holding	810,367,224	742,337,349
	<u>810,367,224</u>	<u>742,337,349</u>

16. Pjesa afatshkurtër e huase afatgjatë

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Hua afatshkurtër Intesa San Paolo Bank	53,251,106	48,780,705
Hua afatshkurtër Prespa Invest	137,280,000	-
	<u>190,531,106</u>	<u>48,780,705</u>

17. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Overdraft	167,026,067	170,113,089
Tituj borxhi-leter garanci	123,022,620	145,765,950
Interesa te perlogaritura	16,771,557	10,101,408
	<u>306,820,244</u>	<u>325,980,447</u>

18. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë	199,106,330	285,853,699
Furnitorë për fatura të pambërritura	13,263,317	-
	<u>212,369,647</u>	<u>285,853,699</u>

19. Parapagime të arkëtuara

Parapagimet e marra më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Parapagime të mara	874,607	801,184
	<u>874,607</u>	<u>801,184</u>

20. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 vijnë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	381,449	405,332
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	146,582	507,879
	<u>528,031</u>	<u>913,211</u>

21. Llogari të tjera të pagueshme

Llogaritë e tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Paga për t'u paguar	1,423,617	2,637,285
Të tjera detyrime	1,239,355	1,587,891
	<u>2,662,972</u>	<u>4,225,176</u>

22. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja e qymyrit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shitje Qymyri	661,199,836	660,077,550
	<u>661,199,836</u>	<u>660,077,550</u>
		<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në		
Qarkullim i tatueshëm		668,927,329
Zbriten Autofaturimet 2015		(363,398)
Shuma e qarkullimit e korrektuar		668,563,931
Sipas Kontabilitetit		<u>668,563,931</u>
Diferenca		<u>-</u>

23. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura të tjera	1,278,355	2,158,274
Të ardhura nga qeraja	6,085,740	5,041,320
	<u>7,364,095</u>	<u>7,199,594</u>

24. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Blerje mallrash- Qymyr	614,110,142	595,712,962
	<u>614,110,142</u>	<u>595,712,962</u>

25. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	20,390,841	22,795,361
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,751,624	2,881,190
	<u>23,142,465</u>	<u>25,676,551</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 24 punonjës (2014: 26 punonjës)

26. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6,428,328	7,531,059
	<u>6,428,328</u>	<u>7,531,059</u>

SEAMENT Albania sh.p.k
 Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
 Të gjitha vlerat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe

27. Shpenzime të tjera

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Transport	22,675,796	20,001,376
Materiale ndihmese dhe lende djegese	1,424,937	267,476
Blerje energji dhe ujë	597,418	625,049
Qira	5,760,000	5,760,000
Mirëmbajtje dhe riparime	235,104	622,069
Shpenzime të tjera të lidhura me doganën	3,574,838	-
Pagesa të ndërmjetësve dhe honorare	1,312,381	7,360,774
Prime të sigurimit	132,100	86,350
Tatime dhe taksa	1,829,824	1,907,588
Shpenzime Telefon dhe Internet	63,185	63,025
Komisione dhe tarifa bankare	648,095	709,637
Gjoha dhe dëmshpërblime	412,992	186,684
Shpenzime të tjera	657,309	355,344
	39,323,979	37,945,372

28. Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzime interesi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	(44,691,830)	(35,844,352)
	(44,691,830)	(35,844,352)

29. Shpenzime të tjera financiare neto

Shpenzime të tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Humbje nga këmbimet valutore	(137,311,764)	(161,165,565)
Të ardhura nga këmbimet valutore	63,603,373	33,753,344
Shpenzime të tjera financiare	(5,433,761)	(12,954,997)
	(79,142,152)	(140,367,218)

32. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

	31 Dhjetor	
	2015	2014
Instrumenta me interest fiks		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	164,736,000	168,168,000
Instrumenta me interest variable	164,736,000	168,168,000
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	383,238,126	450,025,967
	383,238,126	450,025,967

32. Manaxhimi i riskut financiar

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiarë. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Risku i kreditit

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	153,780,790	-	516,466,499	670,247,289
Mjete monetare në arkë dhe bankë	496,262			496,262
Totali	154,277,052	-	516,466,499	670,743,551

Përshkrimi	31 dhjetor 2014			Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 5 vjet	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	113,708,477	54,586,016	602,751,763	771,046,256
Mjete monetare në arkë dhe bankë	605,762			605,762
Totali	114,314,239	54,586,016	602,751,763	771,652,018

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri ne 5 vjet	
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera Hua	(21,903,331)	(9,765,746)	(326,173,748)	(357,842,826)
	(260,302,620)	(237,048,730)	(877,761,558)	(1,375,112,908)
Totali	(282,205,951)	(246,814,476)	(1,203,935,306)	(1,732,955,734)

Përshkrimi	31 dhjetor 2014			Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri ne 5 vjet	
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera Hua	(137,447,399)	(78,200,000)	(102,898,548)	(318,545,947)
	-	(374,761,153)	(995,871,571)	(1,370,632,724)
Totali	(137,447,399)	(452,961,153)	(1,098,770,119)	(1,689,178,671)

32. Manaxhimi i riskut financiar

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			Total
	EUR	LEK	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	31,014,709	411,977,994	227,254,586	670,247,289
Mjete monetare në arkë dhe bankë	61,830	89,557	344,875	496,262
Totali	31,076,539	412,067,551	227,599,461	670,743,551
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(10,811,585)	(194,429,630)	(152,601,611)	(357,842,826)
Hua	(323,373,519)	(24,874,064)	(1,026,865,325)	(1,375,112,908)
Totali	(334,185,104)	(219,303,694)	(1,179,466,936)	(1,732,955,734)
Rreziku i monedhës më 31 Dhjetor 2015	(303,108,565)	192,763,857	(951,867,475)	(1,062,212,183)

Përshkrimi	31 dhjetor 2014			Total
	EUR	LEK	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	32,271,165	528,985,181	209,789,910	771,046,256
Mjete monetare në arkë dhe bankë	42,959	177,743	385,060	605,762
Totali	32,314,124	529,162,924	210,174,970	771,652,018
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(12,917,239)	(41,196,727)	(264,431,981)	(318,545,947)
Hua	(322,979,628)	(24,930,755)	(1,022,722,341)	(1,370,632,724)
Totali	(335,896,867)	(66,127,482)	(1,287,154,322)	(1,689,178,671)
Rreziku i monedhës më 31 Dhjetor 2014	(303,582,743)	463,035,442	(1,076,979,352)	(917,526,653)

33. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

34. Angazhime dhe pasiguri

Angazhimet per qera operative paraqiten me poshte:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Brenda një viti	5,760,000	5,760,000
Më shumë se një vit por më pak se pesë vite	14,400,000	20,160,000
	20,160,000	25,920,000

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

35. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.